



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN SHA

Elbasan, më ____ .02.2026

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Gazoil D1”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09100000-0

**VLERA E FONDIT LIMIT: 8 992 333 (tete milion e nenteqind e nentedhjete e dy mije e
treqind e tridhjetë e tre)leke pa Tvsh**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor shoqëria **UK Rajoni Elbasan**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Blerje Gazoil 10ppm

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk

është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkëpunim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i AK: Vlera e sigurimit të ofertës është llogaritur në 2% të vlerës së fondit limit siç është parashikuar në ligj.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

.....
(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të procedurës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % të të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 5, të VKM

nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forës elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues të paraqesë eksperiencën të mëparshme ku të vërtetojë se ka kryer dhe realizuar kontrata të ngjashme në 3 (tre) vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës objekt prokurimi.

- a- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport analize, të furnizimit të fundit të kryer pavarësisht kohës së këtij furnizimi, të lëshuar nga ISHTI, ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është i huaj materiali duhet të perkthyer dhe të noterizuar në shqip). Enti certifikues (laboratori) duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në RSH (të paraqitet dhe dokumenti i akreditimit të laboratorit).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6, gërma c,) dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në funksion të përlogaritjes dhe hartimit të kontratave në zbatim, ky kriter përbën element thelbësor në përcaktimin e çmimit të karburantit (psh densiteti është pasqyruar në fletë analizë).

2.3.3 Për arsye të specifikës të punës së shoqërisë dhe lëvizjeve të shpeshta që kryhen, subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor më poshtë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie)ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB, Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licensë lëshuar nga pushteti vendor,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Kërkohet të ketë (ne pronesi /ose qera minimumi nga 2 (dy) Stacion tregtimi të karburanteve në qytetin e Elbasanit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pikat 3 dhe 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë arsyetimin dhe logjikën e argumentuar, me faktin që shoqëria ushtron aktivitetin e saj në zonë administrative të gjere dhe do të ishte e nevojshme 2 pika të tregtimit në afërsi të njësisë, pasi kjo do të reduktojë lëvizjen e mjeteve, ul konsumin e panevojshëm të karburantit dhe rrit përfitimin e kohës së punës. Për sa i përket elementëve të tjerë të kërkuar të integruar në të, AK i argumenton si komplementare dhe të arsyeshëm në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe që i garantojnë AK seriozitetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik fitues në gjendje për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Përcaktimi i akteve është bazuar në funksion të mbulimit optimal të territorit që shoqëria administron me pika karburanti, në mënyrë që mjetet e institucionit të mund të aksesojnë në këto shërbime pa vonesa dhe evitimin e te papriturave pa kompromentuar kështu zhvillimin e përditshmërisë së punës.

2.3.4 Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet me kartë elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma ç, të VKM nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar ne VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Për pikat 2.3.6 - 2.3.9: Vetë-deklarimet e mësipërme (si dhe procedura e demonstrimit) kërkohen nga AK si garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është parësore për AK si kriter i veçantë i cilësisë së mallrave që prokurohen dhe, garancisë së Furnizuesit në marrëdhëniet kontraktuale për këtë objekt prokurimi.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet te paraqesë nje deklarate qe merr persiper furnizimin me sherbim 24 ore ne te gjitha pikat.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI II Blerje benzinë

KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohej për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfasuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Argumentimi i AK: Vlera e sigurimit të ofertës është llogaritur në 2% të vlerës së fondit limit siç është parashikuar në ligj.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

.....

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues të vërtetojë që: Xhiroja vjetore minimale e të paktën njërit nga tre (tre) vitet e fundit financiar nga data e zhvillimit të tenderit, duhet të jete jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkurron.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumen e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forës elektronike".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues të paraqesë eksperiencën të mëparshme ku të vërtetojë se ka kryer dhe realizuar kontrata të ngjashme në 3 (tre) vitet e fundit të ushtrimit të aktivitetit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës objekt prokurimi.

- c- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d- b- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fatura tatimore shitjesh të plotësuara sipas legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është

kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një raport analiza, të furnizimit të fundit të kryer pavarësisht kohës së këtij furnizimi, të lëshuar nga ISHTI, ose nga një laborator shqiptar ose i huaj (n.q.s është i huaj materiali duhet të perkthyer dhe të noterizuar në shqip). Enti certifikues (laboratori) duhet të jetë i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në RSH (të paraqitet dhe dokumenti i akreditimit të laboratorit).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 6, gërma c,) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në funksion të përlllogaritjes dhe hartimit të kontratave në zbatim, ky kriter përbën element thelbësor në përcaktimin e çmimit të karburantit (psh densiteti është pasqyruar në fletë analizë).

2.3.3 Për arsye të specifikës të punës së shoqërisë dhe lëvizjeve të shpeshta që kryhen, subjekti ofertues duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë sipas adresave të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor më poshtë, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje ose akt pronësie)ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar lëshuar nga QKB, Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhen të jenë të pajisur me:

- Licensë lëshuar nga pushteti vendor,
- Leje mjedisore të tipit B lëshuar nga QKL,
- Vërtetim teknik lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK),
- Certifikatë të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (MNZSH)
- Policë sigurimi në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakicë, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

Kërkohet të ketë (në pronësi /ose qera minimumi nga 2 (dy) Stacion tregtimi të karburanteve në qytetin e Elbasanit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pikat 3 dhe 5, gërma a,) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Në konceptimin e këtij kriteri AK ka pasur në konsideratë arsyetimin dhe logjikën e argumentuar, me faktin që shoqëria ushtron aktivitetin e saj në zonë administrative të gjere dhe do të ishte e nevojshme 2 pika të tregtimit në afërsi të njësisë, pasi kjo do të reduktojë lëvizjen e mjeteve, ul konsumin e panevojshëm të karburantit dhe rrit përfitimin e kohës së punës. Për sa i përket elementëve të tjerë të kërkuar të integruar në të, AK i argumenton si komplementare dhe të arsyeshëm në përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe që i garantojnë AK seriozitetin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik fitues në gjendje për të përmbushur detyrimet kontraktuale. Përcaktimi i akteve është bazuar në funksion të mbulimit optimal të territorit që shoqëria administron me pika karburanti, në mënyrë që mjetet e institucionit të mund të aksesojnë në këto shërbime pa vonesa dhe evitimin e te papriturave pa kompromentuar kështu zhvillimin e përditshmërisë së punës.

2.3.4 Bazuar në VKM Nr. 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës, duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit, të kryhet me kartë elektronike. Faqja e menaxhimit të karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit të sasisë së karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve, të kryhet nga vetë AK. Ndërfaqja duhet të ofrojë edhe mundësinë e afishimit, si dhe administrimi i sasisë së karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor. Mos ofrimi i shërbimeve të kërkuara më sipër në mënyrë elektronike nëpërmjet Faqes së menaxhimit të karburanteve (webpage), që ofron çdo operator ekonomik pjesëmarrës, përbën kusht për s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika , gërma Ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në VKM Nr 561 datë 29.07.2016 “Për Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshëm” Për pikat 2.3.6 - 2.3.9: Vetë-deklarimet e mësipërme (si dhe procedura e demonstrimit) kërkojnë nga AK si garanci që furnizimi do të realizohet me karta elektronike.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standardeve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka pasur penalitete për shkelje të cilësisë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është parësore për AK si kriter i veçantë i cilësisë së mallrave që prokurohen dhe, garancisë së Furnizuesit në marrëdhëniet kontraktuale për këtë objekt prokurimi.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që merr përse furnizimin me shërbim 24 orë në të gjitha pikat.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.